



Nr. 529 prot.

Tiranë, më 18/04/2024

VENDIM

Nr. 5, Datë 18/04/2024

“PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË DOKUMENTEVE NË KUADËR TË APLIKIMIT PËR POZICIONIN “REKTOR” DHE PËR ANËTAR TË SENATIT AKADEMIK”

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, të Urdhrit nr. 101, datë 13.03.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Arteve”, miratuar me VSA nr. 17, datë 29.03.2024, Komisioni Institucional Zgjedhor,

VENDOSI:

1. Miratimin e formës dhe përmbajtjes së dokumenteve në kuadër të procesit të aplikimit për pozicionin “Rektor” dhe për anëtar të Senatit Akademik, sipas varianteve bashkëngjitur, konkretisht:
 - a) Kërkesë për kandidim për Rektor
 - b) Kërkesë për kandidim për anëtar të Senatit Akademik (staf akademik)
 - c) Kërkesë për kandidim për anëtar të Senatit Akademik (student)
 - d) Vërtetim regjistrimi i kandidatit për Rektor
 - e) Vërtetim regjistrimi i kandidatit për anëtar të Senatit Akademik (staf akademik)
 - f) Vërtetim regjistrimi i kandidatit për anëtar të Senatit Akademik (student)
 - g) Formular vetëdeklarimi për ligjshmërinë e titullit akademik/mungesës së plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës/titullit shkencor.
 - h) Formular vetëdeklarimi se kandidati nuk ka papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 dhe nr. 138/2015.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

KRYETAR

Z. Orges Malaj

Z. Shpëtim Kërçova

Znj. Suela Agolli

Znj. Adela Kusuri

Znj. Sara Caca

SEKRETAR

Z. Redjan Mulla